RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Emri dhe Mbiemri i eks. Shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	Nr. i lëndës:
Kreshnik Berisha	*12.07.2022*	*22.07.2022*	239/22

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 29.06.2022, OE "NT Bajra"- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 239/22, kundër njoftimit për kontratë, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "furnizim me pajisje bujqësore me nr. të prokurimit: 632-22-5204-1-2-1 1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjakovës.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, negocuar, kufizuar, lloji i kontratës: furnizim,
Vlera e parashikuar e kontratës: **113 150,00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Ligji Nr. 04/L-042

Neni 1. Qëllimi LPP
Neni 6. Ekonomiciteti dhe Efikasiteti LPP
Neni 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Dskriminimi LPP
Neni 28. Specifikimet Teknike LPP
Neni 68. LPP/RRUOPP
Neni 69. LPP/RRUOPP
Neni 20. RRUOPP

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

1. Numri i thikave të kërkuara është 24. *Sipas RRUOPP-së Neni 20.4"Specifikimet teknike do të ofrojnë qasje të barabartë për tenderuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të paarsyeshme në hapjen e konkurrencës së prokurimit publik."* Motokultivatorët me fuqi 7.5 kë kanë mundësi funksionimi më të lehtë dhe performancë të njejtë me numër të thikave edhe më të vogël psh. 20 (10+10) kjo për shkak të ruajtjes se fortësisë së boshtit andaj konsiderojmë se një specifikë e tillë teknike është shumë e kufizuar. Specifika teknike si kjo në të cilat nuk janë lejuar minimume dhe maksimume shkelin dispozita ligjore të LPP-së duke favorizuar një prodhues dhe duke diskriminuar prodhues/OE të tjerë *Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi paragrafi 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.*
Si dhe paragrafi 6. Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit;

2. Shtysa ndihmëse:
Boshti i shtyses së epërme dhe shtyses së kardanit FI 30 – kërkojmë lejminin e tolerancës (psh. 20-35 mmFI) pasi një kërkesë e tillë është në kundërshim me ***Neni 28 Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.***

7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licenca ISO - ISO 9001 2015 te jetë valide, Sistemi i Menaxhimit të cilsisë ,ISO-45001 2018 te jetë valide- Sistemi i Menaxhimit të Shendetit dhe sigurisë profesionale, ISO 14001 2015 te jetë valide, Sistemi i

Menaxhimit mjedisor. **Kërkojmë nga autoriteti juaj të anuloj këtë kriter diskriminues për OE Natyra e kontratës është furnizim dhe këtë pjesë e mbulon në tërësi ISO 9001:2015 si standard për një sistem të menaxhimit të cilësisë kur një organizatë:**

a) duhet të demonstrojë aftësinë e saj për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e klientëve dhe të zbatueshëm ligjorë dhe rregullatorë, dhe

b) Synon të përmirësojë kënaqësinë e klientit përmes aplikimit efektiv të sistemit, përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me klientët dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Të gjitha kërkesat e ISO 9001: 2015 janë të përgjithshme dhe ato duhet të jenë të zbatueshme për çdo organizatë, pavarësisht nga llojet ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ajo ofron. Kjo dispozitë shkel Nenin 7 të LPP-së Barazim në Trajtim / Jo – Diskriminimi. Andaj kërkojmë të anulohet si kriter nga kërkesat e përshtatshmërisë profesionale. ISO 45001 Standard që ka të bëjë me sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve dhe ISO 14001 Standard që ka të bëjë me menagjimin e mjedisit, pra asnjëri standard nuk ka të bëjë me cilësin dhe kualitetin e produkteve / pajisjeve. Kualiteti / cilësia përmbushet me ISO 9001:2015.

9. Specifikacioni i pajisjes: *Makina për përzierjen e ushqimit të kafshëve*, janë vendosur specifika teknike fikse, **Neni 28 Autoriteti Kontraktues** është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik. Kërkojmë të lejohen minimumet dhe makismumet.

10. Specifikacioni i pajisjes: *"Mbjellëse 4 rende automatike e misrit"* janë vendosur dimenzione të përgjithshmë fikse: 2800*1620*1100mm. Kërkojmë të vendosen minimumet dhe maksimumet e lejuara. Specifika të tilla fikse shkelin Neni-n 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së si dhe është në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.

11. Specifikacioni i pajisjes: "Spërkatëse" janë vendosur kritere favorizuese dhe aspak të rëndësishme për funksionimin e pajisjes si p.sh. dimensione fikse të konstruksionit të krahëve andaj kërkojmë të eliminohen si specifika teknike apo të vendosen minimume dhe maksimume. Poashtu kërkojmë që tek specifika teknike e presionit të pompës të vendosen minimum maksimumet p.sh 40-50 bar. Specifika të tilla fikse shkelin Neni-n 7. Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi të LPP-së si dhe është në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

1. Numri I kerkuar I thikave per motokultivator eshte 24: ne dosje te tenderit perkatesisht tek Paramasa vendosen speicifikat minimale te kerkuara te cilat qdo autoritet kontraktues I kerkon per nje project apo tener, operatoret ekonomik te cilat shprehin interesim per pjesemarrje ne tender mund te ofertojn produktet te barazvleshme por jo nen kerkese minimale te kerkuar nga autoriteti kontraktues, qe nenkupton kerkesa minimale e jona eshte qe kto frezat per motokultivator numrin e thikave te e ken 24copa, ndersa Operator Ekonomik mund te ofertojn freza me numer te madh te thikave. Per hir te transparences arsyetimi I Operatorit Ekonomik ankues se numri me I vogel I thikave e rruan fortesin e bushtit nuk qendron ngase boshtet e frezave e fortesia e tyre prodhohen duke u bazuar ne numrin e thikave, diametrin e thikes si dhe peshen e thikes, e te cilat pastaj testohen e certifikohen nga kompanit te licensuar te pamvarura ne shtetet e tyre prodhuese. Numri me I madh I thikave nenkupton gjeresin dhe kualitetin e frezimit te tokes andaj kerkesa jone eshte qe numri minimale I thikave te frezes per motokultivator eshte 24cope.
2. Sikurse ne piken paraprake edhe ne kete pike: ne specifikat teknike te vendosur tek Paramasat vendosen kriteret minimale te kerkuara nga AK, Operatoret ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkesen minimale te kerkuar qe dmth kerkesa jone eshte qe kta motokultivator te kene minimalisht FI30.
3. Edhe ne kete pike sikurse ne pikat paraprake Specifikat teknike te vendosura tek Paramasa jane kerkesa minimale, operator ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjeher nen kerkese minimale, kerkesa minimale e AK per peshen e motokultivatorit eshte 190kg
4. Ngjyra e motokultivatorit eshte kerkuar qe te jete gri por Operatoret ekonomik mund te ofertojn edhe me ngjyra tjera, kerkesa e AK-se per ngjyren eshte pershkak te rezistimit te motokultivatorit ndaj korrodimit
5. Numri I shpejtesive 4+2 eshte kerkese fikse dhe nuk lejohet ofertimi me 3+3. Per hire te transparences ne ju shpjegojm domethenie e numrit te shpejtesive: 4 shpejtesi para + 2 shprejtesi mbrapa kerkohen ngase keto motokultivator do perdoren edhe per qellime tjera sipas nevojes dhe kerkeses se fermereve, keto motokultivator do te perdoren edhe me rimorkio e 4 shpejtesi para jane per shpejtesin e levizjes se motokultivator ndersa 2 shpejtesi mbrapa perdoren vetem per pasijen KOSE, e qe dy shpejtesi jane te mjaftueshem per kositje.
6. Edhe ne kete pike sikurse ne pikat paraprake specifikat teknike te vendosura tek Paramasa jane kerkesa minimale te kerkuara nga AK, operatoret ekonomik mund te ofertojn te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK. Kerkesa minimale e AK eshte 11.0km/h.

7. Duke zbatuar ligjin e prokurimit public Ligji Nr.04/L-042 I ndryshuar dhe plotesuar me ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092, Neni 69 – Aftesia teknike dhe/ose Profesionale: ne kemi kerkuar qe Operatoret Ekonomik pjesemarres duhet te jene te certifikuar me Iso Standarde Iso 9001:2015, Iso 45001:2018 dhe Iso 14001:2015 pershkak se:

a) Iso 9011:2015 – ka te beje me sistemin e menaxhimit te cilesis qe nenkupton Operatoret Ekonomik I cili do te beje furnizimin me keto paisje jane te standardizuar per nga ana e cilesis se produkteve qe ata ofrojne nga nje kompani e pamvarur e licensuara per standardizim ne Kosove.

b) Iso 45001:2018 – ky standard ka te beje me menaxhimin, shendetin dhe sigurise profesionale te puntoreve qe ata I kane, e ky kriter tregon profesionalizmin e kompanise dhe seriozitetin e saj per sa ka te beje me kualitetin dhe funksionalitetin e produkteve qe ata ofrojn

c) Iso 14001:2015 – Sistemi I menaxhimit mjedisor: qellimi I te gjitheve eshte mbrojtja e sistemit mjedisor dhe nje kompani e standardizuar me kete standard nenkupton qe paisjet te cilat ata posedojn nuk e degradojn apo demtojn sistemin mjedisor.

8. Ne kete qeshtje eshte bere nje gabim shkrimor ku ne vend se te shkruhet qe katalogjet apo broshurat duhen te jene nga prodhuesi ajo eshte shkruar nga I njejti brend andaj kerkesa jone eshte qe katalogu apo broshura me fotografi duhet te jene nga prodhuesi(referohu: DESHMIA E KERKUAR DOKUMENTARE)

9. Per makina per perzierjen e ushqimit te kafsheve: specifikat teknike tek paramasa jane kerkesa minimale, Operatoret Ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK.

10. Mbjellese 4 rende automatike e miserit: specifikat teknike tek paramasa jane kerkesa minimale, Operatoret Ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK.

11. Sperkateset: specifikat teknike tek paramasa jane kerkesa minimale, Operatoret Ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjehere nen kerkes minimale te kerkuar nga AK. Per dimensioned e konstruksionit te krahve nuk mund te largohet (kerkes e operatorit ekonomik ankues) ngase jane kerkesat minimale qe kerkohen dhe qe plotesojn standardet minimale te nje sperkateses andaj ato mbesin si te tilla.
b) Minimumi I presionit te pompes eshte 50bar, Operatore ekonomik mund te ofertojn paisje te barazvleshme por asnjeher nen kerkes minimale te kerkuara nga AK.

Bazuar ne pergjigjet e lartepermendura ne si autoritet kontraktues nuk kemi bere anje shkelje gjate perpilimit te dosjes se tenderit dhe paramases perkunder ne kemi perpiluar ato pikerisht duke u bazuar ne ligjen e prokurimit publik te Kosoves, dhe te atille kerkesa/ankesa e Operatorit ekonomik eshte e pabazuar.

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Nuk ka raport të komisionit, pasi ankesa është bërë në kritere

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Eksperti teknik sqaron se Rreth pretendimit/kerkesës nr.1 AK duhet që të lejojë pjesëmarrje për OE të cilët ofrojnë edhe numrin minimal të thikave (20), pasi që është kufizim i tepërt dhe mendojmë që edhe me 20 thika mund të kryhet puna në menyrë të duhur (Mund të vlerësohet më shumë më pastaj numri më i lartë i thikave, mirëpo mund të mirret parasyshë edhe aspekti i çmimit në këtë konktekst). Pasi që është pohimi që është problem të gjendet motokultivator me numrin e kërkuar të thikave. Rreth pretendimeve të palëve rreth numrit të thikave dhe punës së motorit, qëndron fakti që çdo element shtesë i cili instalohet në makinën punuese, kërkon fuqi me të madhe dhe e rëndon punën e motorit (Mirëpo në këtë kontekst, duhet që OE që sjellë pajisjen me numër me të lartë të thikave duhet që të sjellë edhe deshmi që pajisja është kompatibile me makinën punuese, pra që nuk e veshtirëson punën e makinës).Në këtë rast, nga aspekti teknik mund të favorizohet ai me shumë thika pasi që qendron pohimi që më shumë thika arrijnë që të bluajnë tokën me mirë.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

Eksperti teknik sqaron se Tek kërkesa e dytë në lidhje me boshtin shtytës të cilin AK e ka kërkuar 30FI , vlerësojmë që edhe këtu duhet që të caktohet një minimum në menyrë që të shmangim përshtatjen për një prodhues të caktuar të motokultivatorëve apo OE. Për këtë pikë, AK duhet që të caktoj një minimum me të ulët sesa ai i përcaktuar në paramasë, mirëpo kjo të mos ndikoj në kualitetin e përgjithshëm të pajisjeve dhe të punëve të cilat duhet të kryhen me anë të këtyre pajisjeve. E konsideroj të padrejtë, favorizimin e parametrave teknik të një prodhuesi (LABIN), në raport me prodhuesit tjerë në kriteret fillestare të tenderit. Pasi që gjatë hulumtimeve kemi verejtur që parametrat teknik të një Motokultivatori të quajtur (Special Green)[1] përputhen në masë të madhe me parametrat minimal të kërkuara nga AK.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

Eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket kërkesave për ISO stanarde, kërkesa për ISO 9001 nuk ka të bëjë me cilësinë e produkteve, andaj nëse qëllimi i AK-së të sigurohet se produktet janë cilësore ISO 9001 nuk jep asnjë garanci në këtë drejtim dhe si e tillë është panevojshme.

Kërkesa për ISO 14001:2015 lidhur me menaxhimin e mjedisit, vlerësojmë se kjo kërkesë duhet drejtuar/kërkuar nga pordhuesi i pajisjeve jo nga OE ofertues, pasi rreziku për ndotje të mjedisit etj, mund të vij pikërisht nga pordhuesit e pajisjeve.

Kërkesa për ISO 45001:2018 lidhur me shëndetin dhe sigurinë në pinë, vlerësojmë se në rast se në Republikën e Kosovës ka ndonjë Ligji i Punës siq pretendon OE ankues i obligon kompanitë të kenë raportin e vlerësimit të riskut, i cili raport trajton menaxhimin e riskut dhe shëndetit në punë, atëher vlerësojmë se një raport i tillë duhet të pranohet nga AK si ekuivalent me kërkesën për ISO 45001:2018.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

Eksperti teknik sqaron se Sa i përket kerkesës me nr. 4. Vlerësohet si e drejtë kërkesa e OE që të përcaktohen minimumet dhe maksimumet e karakteristikave teknike të pajisjeve të cekura, me qëllim që pjesëmarrja në tender të jetë për një numer me të lartë të OE, të cilët mund të ofrojnë zgjedhje me të shumta për AK nga aspekti teknik. Pas kësaj, AK mund të vlerësoj duke u bazuar në karakteristikat teknike dhe në raport me çmimin të përzgjedhë atë OE i cili është më i përshtatshëm nga të dyja aspektet.

Ky raport nuk konsiston në përshtatjen e kërkesave të paramasës për OE ankues, mirëpo ka për qëllim që nga aspekti teknik të ju mundesohet më shumë OE të ofertojnë, në menyrë që AK të bëj zgjedhjen me të mirë nga aspekti teknik-eksploatues si dhe nga aspekti ekonomik.

MENDIMI i EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të bëhen korrigjimet e dosjes së tenderit sipas rekomandimeve në këtë raport, si dhe të shtyhet afati për ofertim në pajtim me dispozitat e LPP-së nenit 53 par.7 të këtij ligji.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Komuna Gjakovë
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - NT Bajra